VENDIM
Nr.327, datë 22.4.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PRONËS SË PËRCAKTUAR NË VENDIMIN NR.53, DATË 26.1.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, LEZHË, TË MJEDISEVE TË KATIT PËRDHES DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR.981, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", LEZHË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pronës së përcaktuar në vendimin nr.53, datë 26.1.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, të mjediseve të katit përdhes dhe të truallit funksional, pjesë të pronës nr.981, me emërtim "Shtëpia e Ushtarakëve", Lezhë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar".
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama